**Legalization**

Seen for legalization the signature of:

- mr. **Christian Maria <u>Strik</u>**, born in Nijmegen (The Netherlands) on the 30th of September 1955, bearer of Dutch passport with number BWDPB03C1, issued in Amsterdam (The Netherlands) on the 16th of January 2017,

by me, mr. Patrick van Zoelen, LLM, acting as substitute for mr. Hendrik Joan Herman Cornelis Eekhoff, LLM, civil law notary in Amsterdam (The Netherlands).

The significance of this statement is strictly limited to the ascertainment of the identity and the signature of the person mentioned herein.

No judgements are made by the undersigned, civil law notary, with respect to – inter alia – the content and possible legal consequences of the attached document or any other aspects thereof.

This certificate may only be relied upon on the express condition that any issues of interpretation or liability there under will be governed by Dutch law and be brought exclusively before a Dutch Court and is subject to the General Conditions of Eekhoff CS Notariaat, which include a limitation of liability clause.

Signed in Amsterdam (The Netherlands), 26th of April 2022

Mr H.J.H.C. EEKHOFF NOTARIS TE AMSTERDAM

# APOSTILLE

(Convention de La Haye du 5 octobre 1961)

1. Country: THE NETHERLANDS
   This public document
2. has been signed by **mr. P. van Zoelen**
3. acting in the capacity of candidate notary at Amsterdam
4. bears the seal/stamp of mr. H.J.H.C. Eekhoff

Certified

5. in Amsterdam
6. on 28-04-2022
7. by the registrar of the district court of Amsterdam
8. no. 10014
9. Seal/stamp:
10. Signature:

H.H.S. Verhagen

RECHTBANK AMSTERDAM

**Legalizimi**

Shihet për legalizim nënshkrimi i:

**Z. Christian Maria Strik**, lindur në Nijmegen (Holandë) më 30 i shtatorit 1955, mbajtës i pasaportës holandeze me numër BWDPB03C1, lëshuar në Amsterdam (Holandë) më 16 janar 2017, nga unë Z. Patrick van Zoelen, LLM, duke vepruar si zëvendësues i Z. Hendrik Joan Herman Cornelis Eekhoff, LLM, noter i së drejtës civile në Amsterdam (Holandë).

Rëndësia e kësaj deklarate është rreptësisht e kufizuar në konstatimin e identitetin dhe nënshkrimin e personit të përmendur këtu.

Asnjë gjykim nuk bëhet nga noteri i poshtëshënuar, i së drejtës civile, në lidhje me ndër të tjera - përmbajtjen dhe pasojat e mundshme juridike ose dokumentin e bashkangjitur ose aspekte të tjera të saj.Kjo certifikatë mund të mbështetet vetëm me kushtin e shprehur që çdo çështje e interpretimi ose përgjegjësia do të rregullohet nga ligji holandez dhe do të sillet ekskluzivisht përpara një gjykate holandeze dhe i nënshtrohet kushteve të përgjithshme të Eekhoff CS Notariaat, të cilat përfshijnë një klauzolë kufizimi të përgjegjësisë.

**Nënshkruar në Amsterdam (Holandë), 26 Prill 2022**

**APOSTILE**

**(Konventa e Hages 5 tetor 1961)**

1. Shteti: Hollande

Ky dokument publik

2. është nënshkruar nga **Z. P. van Zoeler**

3. që vepron në cilësinë e kandidatit për noter në Amsterdami

4. mban vulën/vulën e z. H.J.H.C. Eekhoff

**VERTETUAR**

5. Ne Amsterdam 6. Me 28-04-2022

7. nga sekretari I gjykates se rrethit te Amsterdamit

8. nr. 10014

9.Nenshkrimi dhe Vula 10. Nenshkrim H.H.S Verhagen

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PËRKTHYES ZYRTAR Thodhori Kamberi Përkthyes i njohur nga Min. Drejtësisë OFFICIAL TRANSLATOR

Thodhori Kamber

| AKT THEMELIMI<br>I<br>SHOQËRISË "SI ALBANIA" SHPK | ACT OF INCORPORATION<br>OF<br>THE COMPANY "SI ALBANIA" SHPK |
| --- | --- |
| Sot, në Amsterdam, Hollandë, më 26.04.2022 (dymijë e njëzetë e dy), në praninë e Ortakut të Vetëm Themelues të shoqërisë: | Today, in Amsterdam, The Netherlands, on 26.04. 2022 (two thousand twenty-two), in the presence of the Sole Shareholder of the company: |
| Shoqëria "ARIMO BV", një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe organizuar në përputhje me legjislacionin e Mbretërisë së Holandës, e regjistruar me numrin e identifikimit tatimor 855276939,, me seli në: Amsterdam, përfaqësuar nga administratori, Dutch Trust Management BV, i cili perfaqësohet nga Z. C.M. Strik lindur në Nijmegen, The Netherlands, më 30.09-1955 e banues në Rua do Mato da mina 41 2710-692 Sintra, Portugal, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, me vullnet të plotë, të lirë e të pacenuar,, nënshkruan këtë Akt Themelimi, në përputhje me ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), nëpërmjet të cilit Ortaku i Vetëm Themelues shpreh vullnetin të themelojë shoqërinë "SI ALBANIA" SHPK, me kushtet si vijon: | "ARIMO BV", a private limited liability company founded and organized in accordance with the legislation of the Netherlands, registered with tax identification number 855276939, with its registered seat in: Amsterdam, duly represented by the administrator, Dutch Trust Management BV, which in turn is represented by Mr. C.M. Strik, born in Nijmegen, The Netherlands, on 30.09.1955 and residing in Rua do Mato da mina 41 2710-692 Sintra, Portugal, an adult with full legal capacity to act, with full, free and unviced will, signs this Act of Incorporation, in accordance with the law no. 9901, dated 14.04.2008 "On entrepreneurs and commercial companies", as amended, through which the Sole Founding Shareholder expresses his will to found the company "SI ALBANIA" LLC, as per the following conditions: |
| **NENI 1**<br>**Emri i shoqërisë** | **ARTICLE 1**<br>**Name of the company** |
| 1.1. Emri i shoqërisë do të jetë "SI ALBANIA" SHPK.<br>1.2. Ortaku i vetëm themelues i shoqërisë mban përgjegjësi të kufizuar deri në deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara të kapitalit bazë të shoqërisë. | 1.1. The name of the company shall be "SI ALBANIA" SHPK.<br>1.2. The Sole Shareholder of the company enjoys limited liability up to the up to the amount of unpaid singed contributions of the share capital of the company. |
| **NENI 2**<br>**Forma e shoqërisë** | **ARTICLE 2**<br>**The form of organization** |
| 2.1. Forma e shoqërisë tregtare "SI ALBANIA" SHPK (në vazhdim referuar si "Shoqëria") do të jetë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, sipas | 2.1. The legal form of organization of the company "SI ALBANIA" SHPK (hereinafter referred to as "the Company") shall be that of a limited liability company, according to the |

| | |
|---|---|
| parashikimeve të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar).<br>2.2. Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar. | provisions of law no. 9901, dated 14.04.2008 "On entrepreneurs and commercial companies", as amended.<br>2.2. The Company shall be an Albanian private legal person. |
| **NENI 3**<br>**Selia e shoqërisë** | **ARTICLE 3**<br>**The seat of the company** |
| 3.1. Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë, në adresën: Kilometri 6, Autostrada Tiranë - Durrës, Pranë Fabrikës së Prodhimit të Mobiljeve, Kashar, Tiranë.<br>3.2. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose qytet tjetër brenda Republikës së Shqipërisë, si dhe ka të drejtë të hapë degë ose zyra përfaqësimi të saj kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. | 3.1. The seat of the Company is located in Tirana, at the address: Kilometri 6, Autostrada Tiranë - Durrës, Pranë Fabrikës së Prodhimit të Mobiljeve, Kashar, Tirana.<br>3.2. The Company has the right to change its seat to an address and / or other city within the Republic of Albania, as well as the right to open branches or representative offices anywhere inside or outside the territory of the Republic of Albania. |
| **NENI 4**<br>**Kohëzgjatja e Shoqërisë** | **ARTICLE 4**<br>**Duration of the Company** |
| 4.1. Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një afat kohor të pakufizuar, i cili fillon me regjistrimin e shoqërisë në regjistrin tregtar. Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e saj një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm. | 4.1. The Company shall exercise its activity for an unlimited duration, with the commencement date being that of registration in the commercial register. The shareholders of the Company may decide to limit the term of the activity and then extend it one or several times, according to a special decision. |
| **NENI 5**<br>**Objekti i veprimtarisë** | **ARTICLE 5**<br>**Object of activity** |
| 5.1. Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë, por duke mos u kufizuar në:<br>- arsim, investime në arsim, menaxhim shkollash, investime të tjera të përgjithshme, si dhe çdo aktivitet tjetër të ligjshëm. | 5.1. The object of the Activity of the Company shall be, but not limited to:<br>- education, investments in education, school management, other general investments, as well as any other legal activity. |
| **NENI 6**<br>**Kapitali i Shoqërisë**<br>6.1. Kapitali bazë i shoqërisë është në vlerën 100 (njëqind) lekë, i përbërë nga 1 (një) kuotë, me vlerë nominale prej 100 (njëqind) lek, e cila | **ARTICLE 6**<br>**The Share Capital**<br>6.1. The share capital of the company shall be ALL 100 (one hundred) and is constituted of 1 (one) share, with a nominal value of ALL 100 |

| | |
|---|---|
| jep të drejtën e pjesëmarrjes prej 100% në kapital bazë të shoqërisë.<br><br>6.2. Ortaku i vetëm themelues zotëron 1 (një) kuotë (kuotën e vetme të shoqërisë), e cila jep të drejtën e pjesëmarrjes prej 100% në kapitalin bazë të shoqërisë.<br>6.3. Kapitali bazë është nënshkruar dhe paguar në tërësinë e tij nga ortaku i vetëm themelues. | (one hundred), which grants the right of participation by 100% in the share capital of the company.<br>6.2. The sole founding shareholder owns 1 (one) share (the sole share of the company), which gives the right to participate by 100% in the share capital of the company.<br>6.3. The sole founding shareholder has signed and paid the share capital of the company in its entirety. |
| **NENI 7**<br>**Organet Drejtuese**<br>7.1. Bazuar në dispozitat e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), organet drejtuese të shoqërisë janë:<br>1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve/Mbledhja e Ortakut të Vetëm — organi më i lartë vendimmarrës;<br>2. Administratori — organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.<br>7.2. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. | **ARTICLE 7**<br>**Governing Bodies**<br>7.1. Based on the provisions of law no. 9901, dated 14.04.2008 "On entrepreneurs and commercial companies", as amended, the governing bodies of the company are:<br>1. The General Assembly of Shareholders/ The Meeting of the Sole Shareholder - the highest decision-making body;<br>2. The Administrator - the executive and administrative body of the Company.<br>7.2. The manner of their organization and functioning is defined in the Articles of Association of the Company. |
| **NENI 8**<br>**Administrimi**<br>8.1. Shoqëria do të administrohet nga Administratori i saj, i cili mund të emërohet për një afat deri në pesë vjet me të drejtë riemërimi.<br>8.2. Administrator i vetëm i shoqërisë "SI ALBANIA" SHPK, do të jetë **Zj. Emirljana Erden,** lindur në 21.10.1980 në Fier, banuese në Tiranë, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar.<br>8.3. Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili i ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi, apo nga një ose disa persona të autorizuar prej tij. | **ARTICLE 8**<br>**Administration**<br>8.1. The company shall be administered by its Administrator, who can be elected for a term of up to five years with the right of re-election.<br>8.2. The sole administrator of "SI ALBANIA" SHPK shall be **Mrs. Emirljana Erden**, born on 21.10.1980 in Fier and residing in Tirana, an adult with full legal capacity to act.<br>8.3. The company shall be represented in front of each and every administrative or judicial organ, every other public or private entity and in its relationships with third parties, by its Administrator, who exercises his rights in accordance with the Articles of Association of the Company and the Albanian laws in force, or by one or more persons authorized by him. |

| NENI 9<br>**Ligji i aplikueshëm** | ARTICLE 9<br>**Applicable law** |
|---|---|
| 9.1. Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë, ky akt themelimi, si dhe parashikimet e Statutit të saj. | 9.1. The activity of the Company is governed by the legislation in force in the Republic of Albania, this Act of Incorporation, as well as the provisions of its Articles of Association. |
| **NENI 10**<br>**Regjistrimi** | **ARTICLE 10**<br>**Registration** |
| 10.1. Shoqëria do të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit nga administratori dhe/ose një/disa person(a) të autorizuar prej tij për këtë qëllim, në përputhje me legjislacionin në fuqi. | 10.1. The company shall be registered at the National Business Center by the administrator and / or one / several person (s) authorized by him for this purpose, in accordance with applicable law. |
| **NENI 11**<br>**Dispozitat përfundimtare** | **ARTICLE 11**<br>**Final provisions** |
| 11.1 Ky Akt Themelimi hartohet në 3 (tre) kopje në shqip dhe në anglisht dhe nënshkruhet nga ortaku i vetëm themelues. Gjuha shqipe do të jetë gjuha mbizotëruese. | 11.1 This Act of Incorporation is compiled in 3 (three) copies in Albanian and in English and is signed by the sole founding Shareholder. The Albanian language shall prevail. |
| ORTAKU I VETËM THEMELUES<br>I<br>SHOQËRISË "SI ALBANIA" SHPK<br><br>"ARIMO BV"<br>**Përfaqësuar nga Administratori**<br>**Z. C.M. Strik, për Dutch Trust Management BV** | SOLE FOUNDING SHAREHOLDER<br>OF<br>"SI ALBANIA" SHPK<br><br>"ARIMO BV"<br>**Represented by the administrator**<br>**Mr. C.M. Strik, on behalf of Dutch Trust Management BV** |

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**
**DEGA VENDORE TIRANË**
**NOTER EDLIRA O. MALAJ(GALANXHI)**

V2022053010105432331

| |
|---|
| **DATE 09/05/2022**<br>**NR REP 1774** |

## VËRTETIM PËRKTHIMI

Sot, më datë 09/05/2022, para meje Notere EDLIRA O. MALAJ(GALANXHI), anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën RR.SAMI FRASHERI, PALLATI BLU PERBALLE GJIMNAZIT PETRO NINI LUARASI ,KATI 2, u paraqit personalisht:

**PËRKTHYES**:
Thodhori Kamberi, atësia Kristostom, amësia Amalina, shtetas Shqiptar, lindur në Athinë, Greqi (GRC) dhe banues në TIRANË, me adresë Pjetër Budi; Nd. 19; H. 19; Njësia Administrative Nr. 2; Njësia Bashkiake Nr. 2; 1010; Tiranë, lindur më 18/06/1991, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035071118 dhe nr. personal J10618107T , .

Përkthyesi është i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, i cili më deklaroi se përktheu me përpikmëri dhe saktësi dokumentin bashkangjitur, nga gjuha Anglisht në gjuhën Shqip dhe e nënshkroi rregullisht përpara meje Noteres.

Në referim të nenit 135, i ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë";" në Republikën e Shqipërisë unë Noterja vërtetohet nënshkrimi i përkthyeses.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të këtij veprimi, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER**

**EDLIRA O. MALAJ(GALANXHI)**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË EDLIRA O. GALANXHI NOTER TIRANË